



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:266659

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06755477

KPPP.nr.1462/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.N.T. “Çlirimi”, me NUI: 810248246, me seli në Gllogoc, fshati Nekoc, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arian Prebreza, avokat në Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.518/2024 të datës 18.09.2024 të Përbaruesit Privat Arben Gashi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 24.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.N.T. “Çlirimi”, dhe Urdhri Përbarimor P.nr.518/2024 i datës 18.09.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Arben Gashi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, në bazë të dokumentit përbarues - Vendimit Nr. 01/12-29/23-GJ të datës 02.02.2024, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj debitorit N.N.T. “Çlirimi”, të cilin e ka detyruar që kreditorit në emër të vendimit të përcaktuar si më lartë t’ia paguaj shumën prej 28,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, ashtu që përmbushja e këtyre detyrimeve të realizohet me bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin dhe shënimin e përbarimit në librat publik të paluajtshmërive dhe me shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, për shkak se debitori ka parashtruar padi së bashku me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ, andaj deri në vendosje sipas padisë vendimi nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditore me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, kreditore urdhrin përmbartimor e ka mbështetur në aktvendimin i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, andaj urdhri përmbartimor është i bazuar i argumentuar dhe i ekzekutueshëm. Tutje ka shtuar se kreditore përkatësisht Komisioni i Organit të Shkallës së dytë ka vendosur sipas ankesës së debitorit duke e refuzuar të njëjtën dhe duke lenë në fuqi vendimin e shkallës së parë, në këtë mënyrë vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor është i ekzekutueshëm dhe i përmbartueshëm. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentit përmbartues - Vendimit Nr. 01/12-29/23-GJ të datës 02.02.2024, në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 22 të LPP-së dhe Ligjin Nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Faza e Dytë.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, neni 22 par.1.2 të këtij ligji, fillimisht ka qenë e përcaktuar që si dokument përmbartues paraqitet *“vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*.

Ndërsa, me Ligjin Nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – faza e dytë, Kapitulli XXIV që i referohet ndryshimeve të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me nenin 77 është përcaktuar se “ *Paragrafi 1.2. i nenit 22 të ligjit bazik fshihet*”.

Nga ndryshimet e lartcekura, rezulton se vendimi i organit administrativ që përbën detyrim monetar, tanimë nuk përbën më titull ekzekutiv dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Rrjedhimisht, meqenëse propozimi për përmbartim nga kreditori është iniciuar me datë 17.09.2024, ndërsa ndryshimet e LPP-së përmes Ligjit nr. 08/L-262 kanë hyrë në fuqi me datë 23 gusht 2024, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të Ligjit 08/L-262 në Gazetën Zyrtare, rezulton se në kohën e paraqitjes së propozimit për përmbartim dhe lejimit të përmbartimit, dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk ka paraqitur titull ekzekutiv e rrjedhimisht nuk përbën bazë për lejimin e përmbartimit.

Nga këto të gjetura, e në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par. 1.1 të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse “ *dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë*”, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 71 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1462/24 datë 24.01.2025.

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.